



BW FLASH NEWS

COVID19/ MINISTRIA E SHËNDETËSISË: 697 RASTE TË REJA DHE 6 HUMBJE JETE NË 24 ORËT E FUNDIT. JA SA TESTIME U KRYEN

Fillimi > -Kronikë

Pasi bëhet 'tapë' në lokal, 38-vjeçari qëllon veten me pistoletë, policia e arreston për...

20 Nëntor, 2019 09:31 | 0 shfletime





FIER

Një 38-vjeçar është vetëplagosur me një pistoletë në një lokal në Fier. Ngjarja ka ndodhur në lagjen “29 Nëntori”. Gazetari Ervis Kuçi raporton për ‘**BalkanWeb**’ se Edion Nallbani ka qenë nën ndikimin e alkoolit pasi teksa dilte nga një lokal ka qëlluar veten me pistoletën tip TT, ndërsa është plagosur në dorë. Ai përfundoi pas hekurave pasi armën e dispononte pa leje.



Gjatë kontrollit personal ju gjetën 7 fishekë arme zjarri pistoletë të çilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale së bashku me armën e zjarrit.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprën penale “Armëmbajtje pa leje”.

(ed.me/BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: fier policia